



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Parashitresa-Kancelaria za Predloge i Predstavke-Table Office

No. Prot. 05/2185/Do-1095
Prot. No. 14.06.2016
Data Datum Date: 14.06.2016
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

PËR / ZA / TO	Z. Isa Mustafa Kryeministër i Qeverisë së Kosovës	DATE DATUM DATE	14.06.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Salih Salihu, deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE! <i>Salih Salihu</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		


Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me shkrim në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja

Z. Kryeministër, vitin e kaluar një kompani private duke shkelë legjislacionin për doganat u ka ikur detyrimeve doganore. Konkretisht kemi të bëjmë me futjen e grurit i cili me dokumente është shënuar si hyrje e grurit të thyer, krundeve, bizele, e gërdhushta. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor e ka monitoruar këtë çështje ndërsa rekomandimet janë miratuar edhe në kuvend që kryeministri të raportojë brenda gjashtë muajve për masat e ndërmarra.

Pyetja Parlamentare

Z. Kryeministër, a mund të na tregoni cilat veprime janë ndërmarrë deri më tani?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

PËR / ZA / TO	Z. Avdullah Hoti, Ministër i Financave	DATE DATUM DATE	21.06.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Shqipe Pantina, deputete e Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE! <i>Shqipe Pantina</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja

Dimensioni i menaxhimit të rrezikut përfshin identifikimin, vlerësimin gjykimin e rrezikut. Në këtë fushë siç e dini edhe ju një rëndësi të veçantë ka ndërmarrja e veprimeve për zvogëlimin e rreziqeve dhe parashikimin e tyre. Elemente të tjera të rëndësishme janë edhe monitorimi dhe rishikimi i progresit. Në këtë dimension që vlerëson Raporti i Ministrisë së Financave përgjegjësi kryesorë është që të sigurohet se organizata buxhetore do t'i siguroj objektivat e saj. Është shumë shqetësues fakti që sjellë raporti se 77% e organizatave buxhetore kanë vlerësuar se menaxhimi i rrezikut nuk funksionon, respektivisht funksionon vetëm pjesërisht dhe ka nevojë për përmirësim të mëdha. Kështu për shembull ka probleme sa i përket objektiveve afatmesme në kornizën afatmesme të shpenzimeve, probleme me mungesë planesh në nivel të departamenteve, objektivat nuk janë të njohura për zyrtarët, nuk ka rregulla për zbatimin dhe monitorimin e realizimit të qëllimeve, probleme në identifikimin e rreziqeve nga burimet e brendshme dhe të jashtme deri tek fakti që rreziqet nuk regjistrohen.

Pyetja parlamentare

77% e organizatave buxhetore vlerësojnë se ka probleme të mëdha në menaxhimin e rrezikut, cilat janë këto organizata konkretisht? A i keni identifikuar përgjegjësit për këtë gjendje katastrofike? Kjo gjendje është në kufijtë e krimit ekonomik nga vetë institucionet shtetërore a po i përgatisni dosjet për në departamentet përkatëse të Prokurorisë së shtetit?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Parashitresa-Kancelariaja za Predloge i Prdstavke-Table Office

Nr. Prop. 05/2227/00-11/17
Bi. Pr. /
Prot. No. /

Data / Datum / Date: 21.06.2016
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

PËR / ZA / TO	Z. Avdullah Hoti, Ministër i Financave	DATE DATUM DATE	21.06.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Shqipe Pantina, deputete e Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE! <i>Shqipe Pantina</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja


Sipas ligjit çdo organizatë buxhetore duhet të ketë auditimin e brendshëm. Raporti për Auditimin e brendshëm thotë se jo çdo organizatë buxhetore ka auditorin e brendshëm për shkak të kufizimeve buxhetore.

Po ashtu institucione të cilat dihen dhe publikisht si dhe janë të vërtetuara në raportet e tyre që shpenzojnë për shpërblime edhe pajisje të pajustificuara ndaj bordeve të tyre siç janë: Këshilli i Pavarur Mbikqyres për shërbimin Civil të Kosovës, Komisioni rregullativ i Prokurimit Publik, Zyra e Rregullatorit të energjisë, Autoriteti Rregullativ i komunikimit elektronik dhe Postar e një vargë organizatash të tjera buxhetore nuk e kanë bërë auditimin.

Nga njëra anë ligji kërkon që çdo organizatë buxhetore të ketë auditimin e brendshëm dhe në anën tjetër nuk vihen në shërbim mjetet e nevojshme për ta kryer këtë detyrë? Me fjalë të tjera organizatave buxhetore iu jipen detyra, të cilat janë të obligueshme, por jo edhe mjetet e nevojshme për t'i kryer ato. Ndërkohë po të njëjtave organizata u aprovohet nga koalicioni juaj buxheti për çfarëdo vetshpërblimi jashtë çdo parimi dhe arsyeje për drejtuesit

Pyetja parlamentare

Kur keni në plan të ndani buxhet për auditimin e brendshëm në vend se t'i lejoni anëtarët e bordeve të shpërndorjnë paratë publike?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	<i>Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa</i>	DATE DATUM DATE	10.5.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Raif Qela, deputet		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të nenit 45, pika 2. e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Kur do ta procedoni në Kuvend Projektligjin për Trepçën?
Deri ku ka arritur procedura e përgatitjes së këtij Projektligji?